



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 29

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 6 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Page
Dekret i Presidentit nr. 10734, datë 1.3.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 23.2.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar..... 2067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 28.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar..... 2070
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 28.2.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 2073
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 28.2.2018	Për miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar deri 15 qershor 2018 dhe 15 shtator deri 31 dhjetor 2018, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë..... 2073

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 28.2.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuar) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademia e Marinës - 7 pallatet”, faza I”, Vlorë.....	2075
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 28.2.2018	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të Piktorit të Popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në Centro Culturale Don Orione Artigianelli, Sala Tiziano, Dorsoduro 909/a – Venecia, Itali.....	2081

**DEKRET**

Nr. 10734, datë 1.3.2018

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Afërdita Muhamed Kurtaj
2. Hüseyin Fevzi Inel
3. Nino Akvsenti Zhamutashvili
4. Elena Aleksandr (Aleksander/Alexander) Salillari (Korobova)
5. Brahim Xhemajl Brahimi
6. Qazim Ramadan Gegaj
7. Lejsan (Leysan/Leisan) Sabit Roshniku (Jakupova/Yakupova)
8. Guangdong Hanzhong Li
9. Carlo Alberto Antonio Cavicchioli
10. Erkan Memet Letif Gündüz
11. Flamur Ali Gashi
12. Ali-Imran Musa Shehu
13. Liridon Halim Qarkaxhija
14. Flaka Astrit Binxhiu
15. Fener Şamil Aydın (Yavuz)
16. Aydın Hasan Argin
17. Huzeyfe Osman Uysal
18. Muhammet Ruşen Duman
19. Mehmet Bego Akçiçek
20. Mahmoud Mohamed Ali Naif Alcharkat

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta**VENDIM**

Nr. 116, datë 23.2.2018

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRIT, APARATET E
MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, TË
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË,
PROKURORINË E PËRGJITHSHME,
DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS
DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/2 dhe kudo në vendim:

i) shtohen emërtesat “Agjencia Kombëtare e Diasporës” dhe “Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”;

ii) emërtesa “Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara” zëvendësohet me “Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, dhe kudo në vendim:



i) emërtesa “Agjencia Kombëtare e Provimeve” zëvendësohet me “Qendra e Shërbimeve Arsimore”;

ii) emërtesa “Drejtoria e Patentave dhe Markave” zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale”;

iii) emërtesa “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” zëvendësohet me “Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”;

iv) shtohen emërtesat “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” dhe “Agjencia e Blerjeve të Përqendruara”.

c) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3, dhe kudo në vendim:

i) emërtesat “Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë” dhe “Inspektorati Shtetëror i Ujërave” shfuqizohen;

ii) emërtesa “Reparti i Inspektim-Shpëtim Minierave” zëvendësohet me “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”;

iii) emërtesa “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve” zëvendësohet me “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”;

iv) fjalët “... dhe punonjësit jomësimorë në Universitetin Ushtarak dhe Akademinë e Mbrojtjes ...” shfuqizohen.

ç) Pas pikës 4/16 shtohet pika 4/17, me këtë përmbajtje:

“4/17. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, nëpunësit civilë të njësisë së ekzaminimit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.”.

d) Pas pikës 8/6 shtohen pika 8/7 dhe 8/8, me këtë përmbajtje:

“8/7. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm janë sipas lidhjes nr. 5/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/8. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë e

Prokurimit Publik janë sipas lidhjes nr. 5/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

dh) Në lidhjen nr. 6, që përmendet në pikën 9, emërtesa “Agjencia Kombëtare e Provimeve” zëvendësohet me “Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

e) Pas pikës 9/10 shtohet pika 9/11, me këtë përmbajtje:

“9/11. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara janë sipas lidhjes nr. 6/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ë) Në lidhjen nr. 7, që përmendet në pikën 10, emërtesa “Akademia e Mbrojtjes” shfuqizohet.

f) Lidhja nr. 7/4, që përmendet në pikën 10/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2018:

a) për përcaktimet që lidhen me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë dhe të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2018;

b) për përcaktimet në shkronjat “a”, për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, “c”, për Universitetin Ushtarak dhe Akademinë e Mbrojtjes, dhe “ë” e “f”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) për të gjitha përcaktimet e tjera të fillojnë nga data e transferimit të nëpunësve në pozicionet e reja të punës dhe të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 5/7

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	II-a	1
Përgjegjës Sektori në njësitë e përmbajtjes	III-a	1
Përgjegjës Sektori në njësitë mbështetëse	III-a/1	1
Specialist në njësitë e përmbajtjes	III-b	1 ose 2
Specialist në njësitë mbështetëse	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 5/8

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë e Prokurimit Publik

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	I-b	1
Drejtor Drejtorie	II-b	1
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 6/11

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	II-a	1
Drejtor Drejtorie	II-b	1
Përgjegjës Sektori. Koordinator	III-a	1
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3



Lidhja nr. 7/4

Kategoritë e pagave të punonjësve civilë në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që përcaktohen në pikën 1/3/b, të këtij vendimi

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	II-b	1
Zëvendëstitullar. Kryeinxhinier në Kantierin e Ndërtimit të Anijeve Pashaliman. Drejtor. Përgjegjës Departamenti në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.	III-a	1
Kryeinxhinier	III-a/1	1
Përgjegjës/Shef Sektori/Seksioni. Kryeredaktor	III-b	1
Shef zyre. Zëvendësshef. Specialist në Akademinë e Forcave të Armatosura	IV-a	1
Specialist. Redaktor. Sekretar mësimor në Akademinë e Forcave të Armatosura. Bibliotekar në Akademinë e Forcave të Armatosura	IV-b	1 ose 2 ose 3

VENDIM**Nr. 117, datë 28.2.2018**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 421, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, shkronja “a”, dhe 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të


shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën përfundimtare të pronave, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i destinacionit të një sipërfaqeje prej 428 m² të katit përdhes të godinës, me numër rendor 61 dhe me numër pasurie 4/49, sipas planimetrisë bashkëlidhur, nga fusha e përdorimit “Pronë për realizimin e programeve arsimore”, për t’u përdorur për ngritjen e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara të ADISA-s, në Bashkinë Shkodër.

2. Bashkisë Shkodër i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Edi Rama







VENDIM

Nr. 118, datë 28.2.2018

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në aneksin nr. 3, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën *Shengen*”, bashkëlidhur vendimit, shtohen shtetet “Gjeorgji” dhe “Trinidad dhe Tabako”, me dokumentin pasaportë.

b) Në aneksin nr. 4, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë, dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, bashkëlidhur vendimit, hiqen shtetet “Gjeorgji” dhe “Trinidad dhe Tabako”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 119, datë 28.2.2018

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË
PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E
PRAKTIKËS PROFESIONALE ME
KONTRATË TË PËRKOZHME, PËR
PERIUDHËN 1 JANAR DERI 15
QERSHOR 2018 DHE 15 SHTATOR DERI
31 DHJETOR 2018, PËR MINISTRINË E
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për periudhën 1 janar - 15 qershor 2018 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2018, i cili të jetë 1 500 praktikantë.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, sipas njësive arsimore vendore, dhe afati kohor i kontraktimit të praktikantëve përcaktohen në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale përfitojnë çdo muaj nga punëdhënësi (njësitë arsimore vendore) pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në emër të punëdhënësit dhe të punëmarrësit, në masën 27.9%. Njësitë arsimore vendore (drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore), gjatë periudhës për kryerjen e praktikës profesionale, realizojnë çdo muaj pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në emër të punëdhënësit në masën 16.7%, si dhe në emër të punëmarrësit në masën 11.2%, të përlllogaritur.



4. Masa mujore e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përlogaritët mbi pagën minimale mujore 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë, të miratuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, si dhe nr. 77, datë 28.1.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar. Ndryshimet në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi reflektohen menjëherë në masën e pagesës që punëdhënësi paguan çdo muaj për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

5. Efektet financiare për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2018, të përlogaritur në emër të punëdhënësit dhe të punëmarrësit, në shumën 90 396 000 (nëntëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2018, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Tabela nr. 1; Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, sipas njësive arsimore vendore dhe afati kohor i kontraktimit të praktikantëve për vitin 2018.

Kodi i institucionit	Emërtimi i institucionit arsimor (Njësiti arsimor vendore)	Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 1 janar - 15 qershor 2018	Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 15 shtator - 31 dhjetor 2018
1011002	Drejtoria Arsimore Rajonale Berat	56	56
1011006	Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër	40	40
1011007	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës	88	88
1011008	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan	104	104
1011009	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier	82	82
1011011	Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë	21	21
1011015	Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë	63	63
1011018	Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës	36	36
1011020	Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë	36	36
1011033	Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër	88	88
1011035	Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë	170	170
1011036	Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë	67	67
1011038	Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë	69	69
1011088	Zyra Arsimore Kuçovë	14	14
1011089	Zyra Arsimore Skrapar	13	13
1011090	Zyra Arsimore Bulqizë	20	20
1011092	Zyra Arsimore Mat	31	31
1011096	Zyra Arsimore Krujë	31	31
1011100	Zyra Arsimore Gramsh	22	22
1011101	Zyra Arsimore Librazhd	40	40
1011102	Zyra Arsimore Peqin	16	16
1011105	Zyra Arsimore Lushnjë	66	66
1011106	Zyra Arsimore Mallakastër	16	16
1011109	Zyra Arsimore Përmet	13	13
1011110	Zyra Arsimore Tepelenë	18	18



1011111	Zyra Arsimore Devoll	14	14
1011112	Zyra Arsimore Kolonjë	8	8
1011117	Zyra Arsimore Pogradec	37	37
1011118	Zyra Arsimore Has	12	12
1011120	Zyra Arsimore Tropojë	18	18
1011121	Zyra Arsimore Kurbin	26	26
1011123	Zyra Arsimore Mirditë	18	18
1011124	Zyra Arsimore Malësia e Madhe	20	20
1011125	Zyra Arsimore Pukë	16	16
1011130	Zyra Arsimore Kavajë	36	36
1011132	Zyra Arsimore Delvinë	7	7
1011133	Zyra Arsimore Sarandë	17	17
1011159	Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë	51	51
	TOTALI	1,500	1,500

VENDIM**Nr. 120, datë 28.2.2018**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “RISHIKIM I
KALIMEVE KËMBËSORE (TROUAR)
DHE I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË
RRUGËN “GJYKATË - AKADEMIA E
MARINËS - 7 PALLATET”, FAZA I”,
VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i kalimeve këmbësore (troUAR) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademia e Marinës - 7 pallatet”, faza I”, Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,

sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në listat emërore “Shtojca 1” dhe “Shtojca 2”, me të dhënat e pronarëve që shpronësohen, bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë 76 860 572 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë 76 860 572 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listat emërore “Shtojca 1” dhe “Shtojca 2”, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.



9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Shtojca 1

Tabela përfundimtare me listën e pronarëve të pasurive pronë private dhe vlerat e shpronësimit, për realizimin e projektit
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën "Akademi e Marinës - 7 pallatet"

Çmimi i truallit sipas VKM nr.89, datë 03.02.2016

Çmimi për objektet sipas VKM nr. 138 , datë 23.03.2000 dhe udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016, i EKB Tiranë

NR.	Z K	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe truall	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera totale truall dhe ndërtesë	Shënime
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën "Akademi e Marinës - 7 pallatet"												
1	8602	39/265	Vlorë	Bernard dhe Eduard Caushaj	148.2	10903	1,615,825				1,615,825	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Ka 2 ndërtime pa leje
2	8602	39/266	Vlorë	Jovan Jaupaj	11.22	10903	122,332				122,332	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
3	8602	38/155	Vlorë	Besnik Zyberaj	15.5	10903	168,997				168,997	Saktësim dokumentacioni. Kontrate sipërmarrjeje. Kufizim sekuestro
4	8602	38/154	Vlorë	Levend Zyberaj	12	10903	130,836				130,836	Saktësim dokumentacioni. Kufizim sekuestro
5	8602	38/88	Vlorë	Taulla Zanaj	9.16	10903	99,871				99,871	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
6	8602	36/42/2	Vlorë	BP Hoxha, Toshi, Bedini, Velaj BP (8)	16.7	204	3,407				3,407	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Lloji i pronës ullishte
7	8602	36/164	Vlorë	Sazan Hoxha	4.88	10903	53,207				53,207	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
8	8602	36/162	Vlorë	Sazan Hoxha	12	10903	130,836				130,836	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
9	8602	36/222	Vlorë	Gezim, Ilir dhe Safete Sadiku	9.12	10903	99,435				99,435	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Kufizim veprimesh deri në saktësim skice dhe hipotekuar në favor të Union Bank
10	8602	35/101	Vlorë	Mikel Caushi	20.3	10903	221,330.90				221,331	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Mbi këtë pasuri është dhënë AMTP në emër të M. Aliaj dhe ka 3 nd. pa leje.
11	8602	35/73/2	Vlorë	BP (18) Hasanaj, Muço, Shehu, Vaja, Kreshpa, Ismaili, Idrizaj, Belaj, Sadikaj, Hyso, Jazaj, Bircaj, Mecaj, Mane, Osmenaj, Sinaj, Goga, Hoxhaj, Sina, Duma, Meli, Marku, Alikaj, Murataj, Lame, Zyka.	50.5	10903	550,602				550,602	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Kontratë sipërmarrjeje
12	8602	35/144	Vlorë	BP (45), Vaja, Shehu, Kreshpa, Ismaili, Idrizaj, Belaj, Sadikaj, Hyso, Jazaj, Bircaj, Mecaj, Mane, Osmenaj, Sinaj, Goga, Hoxhaj, Sina, Duma, Meli,	21	10903	228,963				228,963	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Kontratë sipërmarrjeje



				Marku, Alikaj, Murataj, Lame, Zyka								
13	8602	35/122	Vlorë	Perlat dhe Rrufe Lushaj	396.7	10903	4,325,220				4,325,220	Saktësim dokumentacioni. Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Kontratë sipërmarrjeje. Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria 35/52-nd. Objekti i Shkollës së Marinës
14	8602	35/167	Vlorë	Albana, Altin dhe Vitore Licaj	61.3	10903	668,354				668,354	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
15	8602	36/40	Vlorë	BP Luzaj	29	10903	316,187				316,187	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
16	8602	36/175	Vlorë	Razie shehu	24.4	10903	266,033				266,033	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
17	8602	36/267	Vlorë	Hektor Hajro	23	10903	250,769				250,769	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
18	8602	36/117/3	Vlorë	Luan Mezini	23.5	10903	256,221				256,221	Saktësim dokumentacioni.
19	8602	36/117/6	Vlorë	Valentina Luari	18.2	10903	198,435				198,435	Saktësim dokumentacioni.
20	8602	36/119	Vlorë	BP SHEHAJ	2016.6	10903	21,986,990				21,986,990	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
21	8602	36/103	Vlorë	Selim Kondi	1336	10903	14,566,408				14,566,408	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Ka dy ndërtime pa leje
22	8602	36/278	Vlorë	BP Mustafaraj	55	10903	599,665				599,665	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Ka shënime në seksionet përkatëse
23	8602	36/182	Vlorë	BP Opingari, Mustafaraj, Resuli Llohja	1864	204	380,256				380,256	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. TOKË ARE. Sekuestro konservative
Vlera totale e shpronësimit											47,240,178	



Tabela përfundimtare me listën e pronarëve të pasurive pronë private dhe vlerat e shpronësimit, për realizimin e projektit
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademi e Marinës”

Çmimi i truallit sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016

Çmimi për objektet sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 dhe udhëzimi nr. 3, datë 28.12.2016, i EKB-së Tiranë

NR.	Z K	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari		Sipërfaqe truallit m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi m ²	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera totale truall dhe ndërtesë lekë	Shënime
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademi e Marinës”													
1	8602	3/51.	Vlorë	Qemal Lamçe	Truall	27.3	10903	297,652				297,652	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8602	3/22-ND	Vlorë	BP Tafili	Ndërtesë	0	10903	0	82	53,672	4,401,104	4,401,104	Saktësim dokumentacioni. Ngrihet mbi pasurinë 3/54 -T. Ndërtesa është e llojit shtëpi banimi
3	8602	3/54.	Vlorë	Kastriot Tafili, Bukurie Tafili	Truall	170	10903	1,853,510				1,853,510	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Pasuria 3/22-nd ngrihet mbi pasurine 3/54.
4	8602	3/45.	Vlorë	Jani Murataj	Truall	180	10903	1,962,540				1,962,540	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Certifikata e pronësisë, datë 17.7.2014, nuk është lëshuar në bazë të relacionit hartografik
5	8602	3/65.	Vlorë	Nazif Hodaj	Truall	158	10903	1,722,674				1,722,674	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
6	8602	3/26-ND	Vlorë	PPV	Ndërtesë	0	10903	0	66	53,672	3,542,352	3,542,352	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Saktësim dokumentacioni. Në bazë të vërtetimit të faktit Namik Hodaj njihet pronar. Të plotësojë dokumentacionin. Shteti është pronar i pasurisë 3/26-t. Ndërtesa është e llojit shtëpi banimi
7	8602	3/19.	Vlorë	Nasho Risilia	Truall	221.7	10903	2,417,195				2,417,195	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
8	8602	14/326	Vlorë	Artur Alikaj	Truall	50.5	10903	550,602				550,602	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
9	8602	14/311	Vlorë	Thoma Nondo	Truall	41.25	10903	449,749				449,749	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Hipotekohet Banka e Parë e Investimeve.
10	8602	14/329	Vlorë	Reshat Fikaj	Truall	20	10903	218,060.00				218,060	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
11	8602	20/170	Vlorë	Sadik Beqiri	Truall	54.13	10903	590,179.39				590,179	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
12	8602	29/34-T	Vlorë	Fatmir Alikaj	Truall	32	10903	348,896				348,896	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Saktësim dokumentacioni. Në bazë të vërtetimit të faktit Namik Hodaj



													njihet pronar. Të plotësojë dokumentacionin. Shteti është pronar i pasurisë 3/26-t. Ndërtesa është e llojit shtëpi banimi
13	8602	29/34-ND	Vlorë	Fatmir Alikaj	Njesi	0	10903	0	32	49,357.53	1,579,441	1,579,441	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Vlera e ndërtesës me destinacion njësi është llogaritur me situacion punimesh.
14	8602	29/135	Vlorë	Bp Bezhani	Truall	79.7	10903	868,969				868,969	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
15	8602	29/40	Vlorë	BP Sorra, Nuraj, Beqiri	Truall	42	10903	457,926				457,926	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
16	8602	29/96	Vlorë	BP Fallanaj, Beqaj etj.	Truall	99	10903	1,079,397				1,079,397	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Ngrihet pasuria 29/96-ND
17	8602	21/171	Vlorë	Luçjana Gamaj	Truall	10.7	10903	116,662				116,662	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
18	8602	21/170	Vlorë	Adelina Hasanaj	Truall	12	10903	130,836				130,836	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
19	8602	21/149	Vlorë	Ariel Meçaj	Truall	24	10903	261,672				261,672	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
20	8602	21/147	Vlorë	Reshat Fikaj	Truall	14.8	10903	161,364				161,364	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
21	8602	21/144	Vlorë	Izet Kabashaj	Truall	24.4	10903	266,033				266,033	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
22	8602	21/142	Vlorë	Ismet Brokaj	Truall	43.6	10903	475,371				475,371	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
23	8602	15/133	Vlorë	18 BP Dervishi, Palla, Dane, Lacaj	Truall	18	10903	196,254				196,254	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
24	8602	14/304	Vlorë	18 bashkëpronarë Dervishi	Truall	7.2	10903	78,502				78,502	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Mbi këtë pasuri ndodhen 2 ND. Nuk janë shënuar në konfirmime statusit juridik dhe në kartelë emrat e bashkëpronarëve.
25	8602	14/303	Vlorë	Nevila Karafili	Truall	54.5	204	11,118				11,118	Saktësim dokumentacioni. Mbi këtë pasuri ngrihet 14/97-ND2 DHE ND3
26	8602	14/216	Vlorë	18 bashkëpronarë	Truall	9	10903	98,127				98,127	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Nuk janë shënuar në konfirmime statusit juridik dhe në kartelë emrat e bashkëpronarëve.
27	8602	14/226	Vlorë	18 BP Dervishi, Palla, Dane, Lacaj	Truall	400	10903	4,361,200				4,361,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Kufizim me vendim gjykate
28	8601	28/285	Vlorë	Janul Çuka	Truall	18.00	10903	196,254				196,254	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
29	8601	28/283	Vlorë	Janul Çuka	Truall	85	10903	926,755				926,755	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë
Vlera totale e shpronësimit												29,620,394	

**VENDIM****Nr. 121, datë 28.2.2018**

**PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË 11 VEPRAVE TË
PIKTORIT TË POPULLIT VANGJUSH
MIO, ME QËLLIM EKSPOZIMIN E
TYRE NË CENTRO CULTURALE DON
ORIONE ARTIGIANELLI, SALA
TIZIANO, DORSODURO 909/A –
VENECIA, ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të Piktorit të Popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në Centro Culturale Don Orione Artigianelli, Sala Tiziano, Dorsoduro 909/a në Venecia, Itali, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lëvizja e veprave të artit të bëhet për periudhën 1 mars 2018 – 30 prill 2018.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohet znj. Migena Hajdari, përfaqësuese me prokurë të posaçme me nr. 689 rep., nr. 571 kol., të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë procedurën e monitorimit dhe regjistrimin e lëvizjes së veprave.

6. Ngarkohet ministri i Kulturës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

LISTA E OBJEKTEVE – TRASHËGIMI ME VLERA TË VEÇANTA

NR. rend.	KODI QKIPK	NR. INV.	AUTORI KODI I AUTORIT	POSEDUES KODI I POSEDUESIT	TITULLI I VEPRËS
1	17763	7	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NË STUDION E PIKTORIT
2	153944	82	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO
3	17764	23	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET PLAKU (STUDIM) ROM
4	17765	24	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRETI I GRUAS SË PIKTORIT
5	17796	44	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO GRUAJE NË KËMBË
6	17797	45	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO GRUAJE ULUR
7	17778	32	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	TË KORRURAT
8	153941	79	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO
9	153945	83	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET
10.	17793	17	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET “GAJDEXHIU” ROM

LISTA E OBJEKTEVE – TRASHËGIMI ME VLERA TË VEÇANTA

NR. rend.	KODI QKIPK	NR. INV.	AUTORI KODI I AUTORIT	POSEDUES KODI I POSEDUESIT	TITULLI I VEPRËS
1	17758	20	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	AUTOPORTRET

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë